



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës – Gjakovë
01, nr. _____ /2018
Dt. 23.02.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.02.2018, pas diskutimit lidhur me pikën e 4-të, të rendit të ditës: Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës për revokimin e vendimit 01 nr.400-49405 të dt. 25.11.2016, për mbulimin e Shpenzimeve të Varrimit për Qytetarët e Komunës së Gjakovës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Revokohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr.400-49405 të dt. 25.11.2016, për mbulimin e Shpenzimeve të Varrimit për të gjithë Qytetarët e Komunës së Gjakovës .
2. Mbetet në fuqi vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr. 011-67966 i dt.23.09.2015, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit në vlerë prej 200 € për qytetarët e Komunës së Gjakovës, që janë përfutues të skemës Sociale .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetari i Komunës, z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - Drejtoria për Shërbime Publike
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Z. Anton Shala